



BASHKIA MIRDITË
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
MARS 2025

Nr. Rendor	Data e Kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
7	11.03.2025	Kërkesë për Informacion për strukturat e Diasporës dhe Migracionit		Në proces	E plotë	Pa pagesë
8	19.03.2025	Kërkesë për Informacion	07.04.2025	1. A ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup moshën 15-29 vjeç) për periudhën janar -dhjetor 2024? Nëse po, sa përqind të shumës totale të buxhetit zënë këto zëra? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka një planifikim të tillë? Po, Bashkia Mirditë ka patur të planifikuar një zë në buxhetin e vitit 2024 në vlerën 2500000 lek që zë 0.51 % të buxhetit. 2. Sa është numri total i punonjësve në Bashkinë tuaj (2024)? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë	E plotë	Pa pagesë

Numri total i punonjësve në Bashkinë Mirditë është 348 punonjës. Nga këto 195 femra dhe 153 meshkuj.

- 3. Sa është numri i të rinjve (18-29) punonjës të bashkisë tuaj në vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë?**

Numri i të rinjve të punësuar në Bashkinë Mirditë është 24 (njëzetekatër). Nga këto janë 17 femra dhe 7 meshkuj.

- 4. Sa është numri i të rinjve (18-29) të punësuar në bashkinë tuaj, të cilët mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse? (zv.kryetar, drejtor, etj). Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë?**

Numri i punonjësve që mbajnë pozicione drejtuese është 1.

- 5. A ka Bashkia juaj politika rinore të zhvillura specifikisht për grupmoshen 15-29 vjeç?**

Nese jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka të zhvilluar një politike të tilla?

Jo bashkia nuk ka një plan veprimi për rininë. Mbeshtetemi tek Plan Kombëtar për Rininë. Arsyeja pse nuk kemi një set politikash të dedikuara për rininë është se vetëm gjatë fundit të vitit 2024 u formalizua sektori që mbulon çështjet e rinisë.

- 6. A keni në institucionin tuaj, drejtori, sektore, staf të dedikuar për rininë? Prej sa kohesh janë funksionale?**

Spektori i Integrimit Evropian dhe Projekteve mbulon edhe rininë.

- 7. A ka struktura rinore të ngritura në Bashkinë tuaj të dedikuara grupmoshës së të rinjve 15-29 vjeç; (qendra/zyra rinore, keshilla**

rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) per periudhen janar - dhjetor 2024. Nese po, cilat jane ato?

Këshilli Rinor Vendor është struktura rinore që ekziston dhe është përzgjedhur sipas procedurave në Dhjetor 2024 dhe formalizuar në vitin 2025.

8. Me kë keni bashkëpunuar per ngritjen e strukturave te tilla (organizata rinore, grupe te rinjsh, individe, etj)

Kemi bashkëpunuar me një organizatë me fokus te rinjtë si dhe me grupe te rinjsh.

9. A keni nje plan veprimi per Keshillin Rinor Vendor (KVR)? Sa aktivitete jane organizuar nga KVR pergjate 2024?

Plani i veprimit është në proces hartimi. Do te finalizohet dhe implementohet pas periudhës zgjedhore.

10. Për cfare lloj mbeshtetje iniciativa/ bashkepunime keni nevojë per te permiresuar funksionet e KVR ne qytetin tuaj?

Ndihma eshte gjithmone e mirepritur nga OJF qe kane kapacitete dhe ekspertize për të gjitha fushat.

11. Sa te rinj jane te perfshire ne KVR? Sa prej tyre jane femra dhe sa jane meshkuj? Sa prej tyre i perkasin personave me aftesi te kufizuara, edhe sipas gjinise?

KVR përbëhet nga 5 Anëtarë. 2 Meshkuj dhe 3 Femra.

12. A keni pasur ju forma te tjera bashkepunimit (me grupe te rinjsh, organizata rinore, etj) per zhvillimin e aktiviteteve me fokus rinine? Nese po ku kane konsistuar ato?

Nuk kemi zhvilluar aktivitete.

13. Sa eshte me perafersi pjesemarrja e te rinjve ne konsultimet publike te zhvilluara nga bashkia? Cilat jane disa nga mjetet apo mekanizmat qe perdor bashkia ne perfshirjen e te rinjve ne te tilla procese?

Përafërsisht pjesmarrja e të rinjve në konsultimet publike është 50. Thirja për përfshirje është kryer në rrjetet sociale të institucionit si dhe nga administratorët e njësive administrative.

14. Lutemi listoni mjetet e komunikimit qe perdor bashkia juaj dhe link perkatese te faqes se webit te bashkise (website) dhe rrjetet sociale si Facebook dhe Instagram.

<https://bashkiamirdite.gov.al/>

<https://www.facebook.com/share/19E9dXND5a/?mibextid=wwXlfr>

<https://www.instagram.com/bashkiamirdite?igsh=M2U2aDF0NGU0NGF3>

15. Sa eshte numri total i perfituesve nga Skema e Ndhimes Ekonomike per vitin 2024? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?

Numri total i perfituesve nga Skema e Ndhimes Ekonomike per vitin 2024 eshte 624 familje ose 2336 individe, ndarë keto ne 1351 meshkuj dhe 985 femra.

16. Sa eshte numri i te rinjve (15-29 vjes;) perfitues nga Skema e Ndhimes Ekonomike per vitin 2024? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj

Numri i te rinjve (15-29) vjeç, perfitues nga Skema e Ndhimes Ekonomike per vitin 2024 është 379 persona, ndarë keto në 182 meshkuj dhe 197 femra.

17. Sa eshte numri total i perfituesve te Pageses se Aftesise se Kufizuar per vitin 2024? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?

				Numri total i perfituesve te Pageses se Aftesise se Kufizuar per vitin 2024 eshte 535 individe, ndare keto ne 287 femra dhe 248 meshkuj. 18. Sa eshte numri e te rinjve (15-29 vjes;) perfitues te Pageses se Aftesise se Kufizuar per vitin 2024? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj? Numri i te rinjve (15-29) vjeç, perfitues se Pageses se Aftesise se Kufizuar per vitin 2024 eshte 33 individe, ndare keto ne 18 meshkuj dhe 15 femra. 19. Sa eshte numri total i personave te cilatjane pjese e Sherbimeve te Kujdesit Shoqeror per vitin 2024? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj? 20. Sa eshte numri i te rinjve (15-29 vjes;) te cilat jane pjese e Sherbimeve te Kujdesit Shoqeror per vitin 2024? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj? Për pyetjen 19 dhe 20, nuk kemi perfitues te cilet jane pjese e Sherbimeve te Kujdesit Shoqeror.		
9	27.03.2025	Kërkesë për Informacion	09.04.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, drejtuar bashkisë Mirditë ju informojmë si më poshtë vijon: - Bashkia Mirditë nuk ka parashikuar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse gjatë vitit 2024. - Bashkia Mirditë ka bashkëpunuar me OJF që janë partnere në zbatimin e Projekteve "Mirdita Junik" dhe "EFFORT" të financuara nga Programi Cross Border Shqipëri-Kosovë si dhe Projekti "Circle Waste" i finacuar nga Programi Ipa Adriatik Jonian që janë të rregulluara sipas rregullave të menaxhimit të kontratave të granteve dhe marrëveshjeve të partneritetit në kuadër të zbatimit të projekteve dhe nuk bien në kategorinë e ofrimit të fondeve për OJF. - Numri i konsultimeve publike të realizuara nga bashkia Mirditë, për vitin 2024 është 8 konsultime.	E plotë	Pa pagesë

- | | | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|--|
| | | | | <ul style="list-style-type: none">• Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik është Nertila Beqiri. Adresa e emailit: nertila.beqiri@bashkiamirdite.gov.al• Bashkia Mirditë nuk ka koordinatorë për shoqërinë civile.• Në konsultimet publike të organizuara nga bashkia Mirditë nuk ka marrë pjesë asnjë OJF.• Përfaqësues të OJV-ve nuk kanë shprehur interes për tu përfshirë në organe këshillimore.• Në grupet e punës të ngritura nga bashkia Mirditë nuk janë përfshirë OJF.• Bashkia Mirditë nuk ka licensuar ndonjë OJF për shërbime të caktuara. | | |
|--|--|--|--|---|--|--|

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!